



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 410/7 prot.

Tiranë, më 28.04.2026

**VENDIM**

**Nr. 13, datë 28.04.2026**

**PËR KONTROLLUESIN SHOQËRIA “LOFT CONSTRUCTION” SHPK**

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit, si dhe provave të administruara në përfundim të hetimit administrativ në ngarkim të Kontrolluesit Shoqëria “Loft Construction” shpk (në vijim, “Kontrolluesi”),

**KONSTATOHET SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 27, datë 6.02.2026 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u organizua grupi i punës i cili kreu hetimin administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të hetimit, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS M12124033B me objekt aktiviteti: “Ndërtime civile dhe industriale, rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile industriale, veshje fasada, etj.”

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë e të dhënave “punonjës”, “klientë”, “vizitorë” etj. Përpunimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi ka krijuar në platformën “Facebook” dhe “Instagram” profile zyrtare, në të cilën pasqyron veprimtari të ndryshme, duke ilustruar nëpërmjet fotografive dhe videove, të dhënat e subjekteve, punonjës, pjesëmarrës, etj.

U konstatua se, të dhënat e subjekteve më sipër përpunohen/publikohen në rrjetin social “Facebook” dhe “Instagram”, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret për përpunimin e të dhënave, të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit, si dhe pa marrë pëlqimin e tyre, sipas parashikimit të nenit 8 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerësoi se, përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, përmes publikimit të fotografive të subjekteve të të dhënave në platforma si “Facebook” dhe “Instagram”, pa marrë paraprakisht “Pëlqimin”, bie në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të Ligjit.

Bazuar në nenin 8 të Ligjit, “Pëlqim” është çdo element tregues i vullnetit të subjektit të të dhënave, i dhënë lirisht, i informuar dhe i qartë, nëpërmjet të cilit ai, me anë të një deklaratë ose me çdo lloj shfaqjeje tjetër të padyshimtë pohuese të vullnetit, shpreh dakordësinë për përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të për një ose më shumë qëllime specifike.

3. Kontrolluesi ka të instaluar sistemin e video-survejjimit (CCTV), përmes së cilit kryen mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme ku ushtron veprimtarinë e tij. Nga analizimi i planvendosjes së kamerave, konstatohet se disa prej tyre janë të instaluar dhe orientuar në mënyrë të tillë që monitorojnë ambientet e jashtme të ndërtesës, duke përfshirë edhe ambiente të tjera, rrugë kalimi dhe qytetarë, si dhe ambientet e posteve të punës në kundërshtim me pikën 2, të nenit 6 dhe nenin 7 të Ligjit, Udhëzimin nr. 03, datë 30.04.2025, “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video survejjimit” (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”) dhe Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011, “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Nga verifikimet e kryera në sistemin e video-survejjimit (CCTV), rezulton se të dhënat imazhe/video, ruhen përtej afatit ligjor, në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë, sipas pikës 5, të nenit 6 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video-survejjimit (CCTV). Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si: “imazhe” e “video”, janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Gjithashtu vlerësohet se periudha e mbajtjes së të dhënave nuk duhet të kalojë kufirin maksimal të afatit të lejuar, për përmbushjen e qëllimit të video-surveimit. Të dhënat e mbajtura me anë të sistemit të video-surveimit duhet të ruhen për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë, dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar duhet të realizohet shkatërrimi i të dhënave imazhe/video, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 6 të Ligjit dhe të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Nga verifikimi në vend i sistemit të video-surveimit (CCTV), si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, është konstatuar se Kontrolluesi nuk ka miratuar një rregullore të brendshme për administrimin, aksesin, ruajtjen dhe fshirjen e të dhënave imazh/video të përpunuara përmes këtij sistemi, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit.

Për shkak të volumit dhe kategorive të të dhënave personale që përpunon, si dhe natyrës së veprimtarisë së tij, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi është i detyruar të hartojë rregulla/politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave, etj., nëpërmjet sistemit të video-surveimit (CCTV), në përputhje me nenin 28 të Ligjit.

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se, Kontrolluesi disponon rregullore të brendshme *“Mbi trajtimin e të dhënave personale nga punonjësit e Loft Construction shpk”*. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj, si dhe nga analizimi në tërësi i provave të mbledhura gjatë hetimit administrativ, rezulton se, rregullorja parashikon vetëm afatin për ruajtjen maksimale të filmimeve (deri në 30 ditë), por nuk përcakton afatet e mbajtjes së të dhënave, që administrohen nga Kontrolluesi, në ushtrim të veprimtarisë së tij. Gjithashtu, mungojnë parashikime mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, si mënyra e mbledhjes, regjistrimit, ruajtjes dhe asgjësimit të tyre, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese që kryen, sipas parashikimeve të nenit 27 dhe 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e pikës 5, të nenit 6 të Ligjit.

Gjithashtu, në rregullore duhet të përcaktohen në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura organizative për të gjitha aspektet e përpunimit të të dhënave, duke përfshirë, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë fizike, teknike dhe administrative, ruajtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave, aksesin, si dhe afatet e ruajtjes së të dhënave. Plotësimi i rregullores me të gjithë elementët ligjorë të përcaktuar në pikën

1 të nenit 27 të Ligjit, konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

5. Rezulton se, Kontrolluesi nuk ka marrë masat e duhura teknike dhe organizative për të garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, duke përfshirë, ndër të tjera, *pseudonimizimin dhe enkriptimin e të dhënave personale; aftësinë për të garantuar konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve dhe të shërbimeve të përpunimit; aftësinë për të rivendosur disponueshmërinë dhe aksesin në të dhënat personale brenda një kohe të arsyeshme në rast incidenti fizik ose teknik; një proces për testimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e rregullt të efikasitetit të masave teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e përpunimit etj.*, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” (në vijim, “Vendimi nr. 6”).

Gjithashtu, konstatohet se Kontrolluesi nuk mban dokumentacion mbi veprimtaritë e përpunimit, me qëllim demonstrimin e përputhshmërisë me ligjin, në formë të shkruar dhe në format elektronik, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit.

Kontrolluesi, duke marrë në konsideratë natyrën e veprimtarisë së tij, nuk ka marrë masa për të krijuar, zbatuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme një Sistem Menaxhimi të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System “PIMS”*), sipas Udhëzimit nr. 09, datë 20.11.2025 “Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale” (në vijim, “Udhëzimi nr. 09”).

Kuadri ligjor evropian mbi mbrojtjen e të dhënave personale, të cilin Ligji transpozon, dhe praktika më e mirë evropiane, e konsideron certifikimin si një mekanizëm përputhshmërie me Ligjin<sup>1</sup> dhe për të inkurajuar zbatimin e tij, i krijon rast pas rasti kontrolluesve që e zbatojnë atë në mënyrë efektive, një pozitë preferenciale në kryerjen e disa veprimtarive përpunuese të caktuara, siç janë për shembull transferimet ndërkombëtare. Në këtë kuadër, në zbatim të nenit 37 të Ligjit, i cili parashikon dhe rregullon mekanizmin e certifikimit, Komisioneri ka miratuar Udhëzimin nr. 08 datë 20.11.2025 “Për kriteret shtesë për akreditimin e organizmave certifikues” (në vijim, “Udhëzimi nr. 08”) dhe Udhëzimin nr. 09.

Udhëzimi nr. 09 referon në Sistemet e Menaxhimit të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System “PIMS”*) dhe Komisioneri inkurajon kontrolluesit, të cilët për shkak të natyrës së veprimtarisë së tyre, e kanë të nevojshëm ngritjen e një sistemi të tillë me qëllim standardizimin dhe rregullimin e veprimtarisë përpunuese dhe garantimin e sigurisë së përpunimit të të dhënave personale, të zbatojnë Udhëzimin nr. 08 dhe nr. 09.

---

<sup>1</sup> Pika 3 e nenit 22, pika 3 e nenit 23, pika 3 e nenit 28

Në rastin konkret, Zyra e Komisionerit ka vlerësuar se, për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi duhet të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë një sistem menaxhimi të të dhënave personale (PIMS) në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 09.

Bazuar në nenin 28 të Ligjit dhe nenin 13 të Udhëzimit nr. 09, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete teknike dhe organizative që garantojnë nivel të përshtatshëm për rrezikun, masa të cilat duhet të rishikohen në mënyrë periodike për të siguruar efektivitet të vazhdueshëm.

6. Rezulton se, Kontrolluesi aplikon për punëmarrësit deklaratën e konfidencialitetit, si aneks i kontratës së punës. Megjithatë, nga analizimi i përmbajtjes së saj, evidentohet se nuk parashikohen të drejtat dhe detyrimet për ruajtjen e konfidencialitetit në përputhje me parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale për nëpunësit që kanë akses në të dhënat personale, në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, qëllimi i nënshkrimit të “*Deklaratës së Konfidencialitetit*” është që të gjithë punonjësit, të cilët kanë akses për arsye profesionale në procese përpunuese dhe në të dhënat personale, të kuptojnë qartë dhe drejtë, detyrimet dhe përgjegjësitë që ata kanë mbi përpunimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

7. Nga verifikimi në vend, ka rezultuar se Kontrolluesi e ka të organizuar rrjetin e brendshëm të intranetit me pajisje kompjuterike, të cilat nuk janë të qendëruara sipas modelit të *domain controller*-it apo ekuivalente, duke sjellë mungesën e një arkitekture të unifikuar për administrimin e përdoruesve, autorizimeve dhe politikave të sigurisë. Kjo mënyrë organizimi rrit rrezikun për akses të paautorizuar, mungesë gjurmueshmërie dhe dobësi në menaxhimin e privilegjeve, në kundërshtim me kërkesat e nenit 27 dhe 28 të Ligjit për garantimin e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave personale përmes masave të përshtatshme teknike.

Gjithashtu, masat e sigurisë teknike të sigurisë që përdor Kontrolluesi për infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, nuk i përgjigjen standardeve më të mira ndërkombëtare, duke mos ofruar mekanizma të avancuar filtrimi, monitorimi dhe parandalimi të ndërhyrjeve (IPS/IDS, etj.), çka cenon kërkesën e nenit 28 të Ligjit për zbatimin e masave teknike të përshtatshme në raport me rrezikun.

Zyra e Komisionerit ka vlerësuar se kontrolluesit, në referim të kërkesave të përcaktuara në nenin 28 të Ligjit, duhet të zbatojnë masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel të përshtatshëm ndaj rrezikut. Në vlerësimin e nivelit të përshtatshëm të sigurisë duhet të merren parasysh veçanërisht rreziqet që shkaktohen nga përpunimi, specifikisht, nga shkatërrimi aksidental ose i paligjshëm, humbja, ndryshimi, përhapja e paautorizuar ose aksesit në të dhënat personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara në çfarëdolloj mënyre.

8. Nga verifikimi *on-site* i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, si dhe nga shqyrtimi i procedurave rregulluese të Kontrolluesit, rezulton se:

- Kontrolluesi nuk ka hartuar dhe miratuar plane të dokumentuara për menaxhimin e riskut, përfshirë identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e rreziqeve që lidhen me përpunimin e të dhënave personale, si dhe nuk ka përcaktuar teknikat dhe mekanizmat përkatës të menaxhimit dhe monitorimit të performancës së masave të sigurisë, në kundërshtim me detyrimin për të garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm sipas parimit të llogaridhënies;
- Kontrolluesi nuk ka të hartuar planin e politikave të vazhdueshmërisë së biznesit, dokumente këto që do të duhet të përmbanin politikat dhe objektivat që sigurojnë vijueshmërinë e punës;
- Kontrolluesi nuk ka të specifikuar/dokumentuar kohën maksimale në të cilën shërbimet dhe sistemet nuk mund të jenë funksionale, si dhe nuk janë planifikuar masa që në rast dështimi të një/disa pajisjeve të mos ndikohet në funksionimin e sistemeve dhe shërbimeve të ofruara;
- Kontrolluesi nuk ka kryer auditime të brendshme me qëllim garantimin e mirëfunksionimit të këtyre teknikave për menaxhimin e riskut (ose në mungesë të teknikave, identifikim të riskut);
- Politikat mbi gjurmët (*log-et*) për infrastrukturën mbështetëse TIK, nuk zbatohen sipas një procedure të rregulluar, me risk në qasje të paautorizuar në të dhëna, kërcënim të sigurisë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe mungesë transparence.

Gjithashtu, konstatohet se masat e ndërmarra në drejtim të *backup*-it janë të pamjaftueshme dhe nuk japin siguri në mbështetjen e planit të vazhdueshmërisë së biznesit (BCP) dhe planit të rimëkëmbjes nga katastrofa (DRP), në kundërshtim kjo me masat e sigurisë së informacionit. Nuk u gjetën procedurat e rikrijimit (*restore*) të *backup*-it të të dhënave me qëllim testimin e tyre për t'u siguruar që ato janë të efektshme dhe që mund të ekzekutohen brenda kohës së lejuar. Këto procedura duhet të testohen rregullisht, sistematikisht dhe vazhdimisht.

Për sa më sipër, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht në këtë rast kur përpunimi i të dhënave kryhet nëpërmjet komunikimeve elektronike, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, mungesa e një plani të strukturuar për menaxhimin e riskut, e reflektuar në mos hartimin e procedurave për identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e rreziqeve, si dhe në mungesën e auditimeve të brendshme dhe monitorimit të vazhdueshëm të masave të sigurisë, cenon drejtpërdrejt parimin e llogaridhënies sipas nenit 6 dhe detyrimet e nenit 28 të Ligjit. Pa një analizë të bazuar në risk, Kontrolluesi nuk është në gjendje të përcaktojë masa të përshtatshme teknike

dhe organizative, duke krijuar ekspozim të lartë ndaj incidenteve të sigurisë, aksesit të paautorizuar dhe përpunimeve të paligjshme të të dhënave personale.

Në të njëjtën kohë, mungesa e planeve të vazhdueshmërisë së biznesit (BCP) dhe e planeve të rikuperimit nga katastrofat (DRP), si dhe mos përcaktimi i parametrave kritikë, si koha maksimale e ndërprerjes së shërbimeve (RTO/RPO), tregojnë një mungesë të planifikimit për garantimin e disponueshmërisë dhe integritetit të të dhënave. Këto mangësi rrisin ndjeshëm rrezikun që, në rast dështimi teknik apo incidenti kibernetik, të dhënat personale të mos rikuperohen brenda një afati të pranueshëm ose të humbasin në mënyrë të pakthyeshme, duke cenuar të drejtat dhe interesat e subjekteve të të dhënave.

Gjithashtu, mungesa e procedurave të rregulluara për administrimin e *log-eve* dhe pamjaftueshmëria e masave të *backup-it*, e shoqëruar me mungesën e testimit të rregullt të rikthimit të të dhënave (*restore*), tregon se masat e sigurisë janë të paplota dhe jo efektive në praktikë. Në këto kushte, Kontrolluesi nuk garanton gjurmueshmërinë e veprimeve mbi të dhënat, transparencën dhe aftësinë për të reaguar ndaj incidenteve, duke qenë në kundërshtim me kërkesat e nenit 28 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit.

9. Konstatohet se, aktivitetet kryesore të Kontrolluesit janë procese përpunimi, të cilat, për shkak të natyrës, fushës së zbatimit ose qëllimeve të tyre, kërkojnë monitorim të rregullt e sistematik të subjekteve të të dhënave në një shkallë të gjerë. Megjithatë, Kontrolluesi nuk ka emëruar një nëpunës të mbrojtjes së të dhënave personale, në kundërshtim me nenin 33 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, aktivitetet e Kontrolluesit përfshijnë procese përpunimi të të dhënave personale që, për shkak të natyrës dhe mënyrës së realizimit të tyre, karakterizohen nga monitorim i vazhdueshëm i subjekteve të të dhënave. Konkretisht, përdorimi i sistemit të video-survejjimit (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të punës dhe hapësirave përreth, si dhe publikimi i vazhdueshëm i imazheve dhe videove në rrjetet sociale, që përfshijnë punonjës, klientë dhe persona të tretë, përbëjnë forma të përpunimit të cilat realizohen në mënyrë të strukturuar dhe të përsëritur në kohë.

Në këtë kuptim, këto procese përpunimi përbëjnë monitorim të rregullt dhe sistematik të subjekteve të të dhënave, pasi ato nuk janë të rastësishme apo sporadike, por pjesë integrale e ushtrimit të veprimtarisë së Kontrolluesit.

Në këto kushte, në përputhje me nenin 33 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për caktimin e një nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili do të sigurojë mbikëqyrjen e respektimit të legjislacionit në fuqi dhe përputhshmërinë e proceseve përpunuese me kërkesat ligjore.

Gjithashtu, bazuar në pikën 3, të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për të publikuar të dhënat e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave, në mënyrë që subjektet e të dhënave të mund ta kontaktojnë atë, për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin

e të dhënave të tyre personale dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, sipas këtij ligji, si dhe për t'ia njoftuar ato Zyrës së Komisionerit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit në rrugë postare dhe në formë elektronike.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, është paraqitur në seancën dëgjimore, të datës 24.03.2026, të organizuar nga Zyra e Komisionerit, gjatë të cilës ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, si dhe bashkëpunimin me Komisionerin për të siguruar që çdo mangësi të adresohet në përputhje me Ligjin.

Gjithashtu, nga ana e Kontrolluesit, me shkresën e datës 19.03.2026, protokolluar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 410/5 prot., datë 24.03.2026, është përcjellë dokumentacioni mbi masat e marra në funksion të përmbushjes së detyrimeve të Ligjit dhe parashtrimeve lidhur me konstatimet e grupit të hetimit, si më poshtë:

- Lidhur me pikën 2 të procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi pretendon se “*Pëlqimi*” është marrë vazhdimisht nga ana e punonjësve dhe lidhur me këtë ka përcjellë dokumentacion provues.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Veprimi i Kontrolluesit për të publikuar fotografi dhe video të punonjësve, pjesëmarrësve dhe subjekteve të tjera në profilet zyrtare në “*Facebook*” dhe “*Instagram*”, pa marrë më parë pëlqimin e tyre, përbën shkelje të drejtpërdrejtë të parimeve themelore të mbrojtjes së të dhënave personale. Sipas neneve 6 dhe 7 të Ligjit, çdo përpunim i të dhënave personale duhet të jetë i ligjshëm, i drejtë dhe transparent, dhe të bazohet në një nga kushtet e përcaktuara. Gjithashtu, neni 8 i Ligjit përcakton qartë se pëlqimi duhet të jetë i lirë, i informuar dhe i shprehur qartë. Mungesa e këtij pëlqimi paraprak e bën përpunimin të paligjshëm, duke ekspozuar Kontrolluesin ndaj përgjegjësisë dhe duke cenuar të drejtën e subjekteve për privatësi.

- Lidhur me pikën 3 të procesverbalit të hetimit administrativ, nga ana e Kontrolluesit pretendohet se është ri pozicionuar planvendosja e kamerave të survejimit vetëm në drejtim të portës së hyrjes së ambientit, duke bashkëlidhur mbi këtë fakt fotot dhe provat përkatëse. Gjithashtu, lidhur me afatin e ruajtjes së pamjeve imazh/video nga ana e Kontrolluesit pretendohet se janë marrë masat përkatëse për respektimin e detyrimeve ligjore dhe reflektimin e tyre në rregulloren e përditësuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Së pari, disa kamera janë orientuar në mënyrë të tillë që monitorojnë ambiente të jashtme të ndërtesës, duke përfshirë rrugë kalimi dhe qytetarë të panjohur, si dhe ambiente të posteve të punës, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 6 dhe nenin 7 të Ligjit, si dhe me

Udhëzimin nr. 3 dhe Udhëzimin nr. 11. Ky lloj monitorimi përpunon të dhëna personale të personave, që nuk kanë asnjë lidhje me veprimtarinë e Kontrolluesit, duke cenuar të drejtën e tyre për privatësi dhe duke shkelur parimin e proporcionalitetit. Së dyti, të dhënat imazhe/video ruhen përtej afatit ligjor prej 30 ditësh, në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë sipas pikës 5 të nenit 6 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit. Mbajtja e tyre më gjatë se sa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit të video-survejitimit e bën përpunimin të paligjshëm, dhe në mungesë të shkatërrimit të menjëhershëm pas përfundimit të afatit, Kontrolluesi mban përgjegjësi për përpunimin e mëtejshëm.

- Lidhur me konstatimet në pikat 5 dhe 6, të procesverbalit, nga ana e Kontrolluesit janë marrë masat duke ndërtuar një domain controller me server dhe *Active Directory* ku çdo punonjës që ka akses në këtë sistem, ka kredencialet e tij dhe akses të kufizuar. Gjithashtu, është realizuar ruajtja e log-eve të sistemit nga vetë sistemi, i cili mban shënime (logs) lidhur me hyrjen dhe kohën e hyrjes në sistem.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Organizimi i rrjetit të brendshëm të intranetit nga Kontrolluesi paraqet dobësi serioze në sigurinë e të dhënave personale. Pajisjet kompjuterike nuk janë të qendëruara sipas një modeli *domain controller*-i ose ekuivalent, duke sjellë mungesën e një arkitekture të unifikuar për administrimin e përdoruesve, autorizimeve dhe politikave të sigurisë. Kjo mënyrë organizimi rrit ndjeshëm rrezikun për akses të paautorizuar, mungesë të gjurmueshmërisë dhe dobësi në menaxhimin e privilegjeve, në kundërshtim me kërkesat e neneve 27 dhe 28 të Ligjit për garantimin e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave personale.

Për më tepër, masat e sigurisë teknike të përdorura për infrastrukturën e IT-së nuk i përgjigjen standardeve më të mira ndërkombëtare, duke mos ofruar mekanizma të avancuar filtrimi, monitorimi dhe parandalimi të ndërhyrjeve (si IPS/IDS). Kjo cenon kërkesën e nenit 28 të Ligjit për implementimin e masave teknike të përshtatshme në raport me rrezikun, duke ekspozuar të dhënat personale ndaj rreziqeve të shkatërrimit aksidental ose të paligjshëm, humbjes, ndryshimit, përhapjes së paautorizuar ose aksesit të paligjshëm.

- Lidhur me konstatimet në pikën 8 të procesverbalit, nga ana e Kontrolluesit është përgatitur Plani i *Backup*, Procedura e *Backup*, Analiza e Riskut, Masat teknike dhe organizative, informimi i subjekteve dhe trajnimi i stafit lidhur me detyrimet e reja ligjore, me qëllim shmangien e çdo incidenti të mundshëm në të ardhmen.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Kontrolluesi nuk ka zbatuar një sistem të strukturuar dhe të dokumentuar për menaxhimin e riskut lidhur me përpunimin e të dhënave personale, duke shkelur parimin e llogaridhënies sipas nenit 6 dhe detyrimet e nenit 28 të Ligjit. Konkretisht, mungojnë identifikimi, analizimi dhe vlerësimi i rreziqeve, si dhe teknikat përkatëse të menaxhimit dhe monitorimit të masave të sigurisë. Gjithashtu, nuk ekziston asnjë plan i vazhdueshmërisë së biznesit (BCP) apo plan i rimëkëmbjes nga katastrofa (DRP),

duke përfshirë përcaktimin e kohës maksimale të lejuar të ndërprerjes së shërbimeve.

Në përfundim u vlerësua se, shkeljet e konstatuara gjatë procesit të hetimit administrativ, të tilla si: mos dokumentimi për veprimtaritë përpunuese të Kontrolluesit në funksion të përputhshmërisë me Ligjin; mungesa e masave tekniko-organizative; mos zbatimi i detyrimit për konfidencialitetin dhe caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, në kuptim të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 94 të Ligjit, si dhe shkelja e parimeve dhe kritereve ligjore të përpunimit të të dhënave personale, në kuptim të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 94 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

*“1. Bazuar edhe në rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të këtij ligji, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 1 000 000 000 (një miliard) lekë, ose në rastin e një shoqërie tregtare deri në 2% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado është më e lartë, shkeljet e detyrimeve:*

*a) të kontrolluesit dhe përpunuesit, sipas neneve 8, pika 6, e 11, të kapitullit III, të pjesës II të këtij ligji, me përjashtim të nenit 22 të këtij ligji;*

*2. Bazuar edhe në rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 2 000 000 000 (dy miliardë) lekë, ose në rastin e një shoqërie tregtare, deri në 4% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado që është më e lartë, shkeljet e mëposhtme:*

*a) moszbatimi i parimeve themelore të përpunimit, përfshirë kushtet për dhënien e pëlqimit, sipas neneve 6, 7, 8 e 9, të këtij ligji;*

Në këto kushte, Komisioneri vlerësoi se, dokumentacioni i paraqitur nuk përmbush kërkesat e parashikuara nga Ligji dhe nuk mund të konsiderohet si provë e mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e masave të nevojshme organizative dhe teknike që Kontrolluesi ka detyrimin të zbatojë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rrjedhimisht, aktet e referuara nuk prodhojnë efekt juridik për qëllime të zbatimit të Ligjit.

Në rrethanat e shqyrtimit të kësaj çështje, Komisioneri evidenton shkallën e bashkëpunimit nga ana e Kontrolluesit. Gjithashtu, në llogaritjen e masës së sanksionit administrativ me gjobë, Komisioneri ka marrë në konsideratë xhiron vjetore të deklaruar nga Kontrolluesi, si dhe rëndësinë e proceseve përpunuese.

Sa më sipër, mbështetur në dispozitat e Udhëzimit nr. 06, datë 16.07.2025, “Për miratimin e metodologjisë për përlogaritjen e masës së sanksioneve administrative”, veçanërisht në pikat 4 dhe 5, të Nënkapitullit 2.1 të Kapitullit 2 dhe të Kapitullit 4, Komisioneri ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe transparente masën e sanksionit administrativ ndaj Kontrolluesit, sipas përcaktimeve të neneve 93 dhe 94 të Ligjit, duke u bazuar në kufijtë minimalë të përlogaritjes.

Komisioneri vlerëson faktin se, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe kritereve për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme tekniko-organizative për sigurinë e të dhënave

personale. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 6, 7, 8, 27, 28, 30, 33, 81-84, pikës 1 të nenit 87, nenit 93, shkronjës “a” të pikës 1 dhe shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 94, si dhe nenit 95 të Ligjit, dhe të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Komisioneri,

### **V E N D O S I:**

1. Dënimin e Kontrolluesit Shoqëria “Loft Construction” shpk, me gjobë në masën **1,010,000** (një milion e dhjetë mijë) Lekë, për shkelje të neneve 6, 7 dhe 8 të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit Shoqëria “Loft Construction” shpk, me gjobë në masën **707,000** (shtatë qind e shtatë mijë) Lekë, për shkelje të neneve 27, 28, 30 dhe 33 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, Shoqëria “Loft Construction” shpk, urdhërohet të marrë masa për marrjen dhe administrimin e “Pëlqimit” të subjekteve të të dhënave në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 6, 7 dhe 8 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, Shoqëria “Loft Construction” shpk, urdhërohet të marrë masa për përcaktimin e planeve të kamerave përmes sistemit të video-survejimit (CCTV), si dhe përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjithë proceset e përpunimit, në përputhje me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm;
5. Kontrolluesi, Shoqëria “Loft Construction” shpk, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, urdhërohet të marrë masa për përditësimin e rregullores “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke parashikuar në të, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, përcaktimin e niveleve të aksesit, afatet e ruajtjes, etj.;
6. Kontrolluesi, Shoqëria “Loft Construction” shpk, në zbatim të nenit 30 të Ligjit, duhet të reflektojë në mënyrë të qartë dhe të drejtë detyrimet dhe përgjegjësitë në “Deklaratën e Konfidencialitetit” me punëmarrësit të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale;

7. Kontrolluesi, Shoqëria “*Loft Construction*” shpk, urdhërohet të marrë masa për caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 34 të Ligjit, si dhe të njoftojë Zyrën e Komisionerit për caktimin e tij;
8. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, detyrimet sipas këtij akti duhet të përmbushen brenda afateve si vijon:
  - (i) menjëherë - detyrimin e përcaktuar në pikën 4) të dispozitivit të këtij vendimi;
  - (ii) vazhdimisht - detyrimin e përcaktuar në pikën 3) të dispozitivit të këtij vendimi;
  - (iii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve - detyrimin e përcaktuar në pikën 5) të dispozitivit të këtij vendimi;
  - (iv) brenda 30 (tridhjetë) ditëve - detyrimet e përcaktuara në pikat 6) dhe 7) të dispozitivit të këtij vendimi;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

9. Kontrolluesi, Shoqëria “*Loft Construction*” shpk, duhet të njoftojë Komisionerin për masat e marra brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, duke filluar nga data e marrjes dijeni të këtij vendimi;
10. Vendimi për dënimin me gjobë përbën “titull ekzekutiv” dhe zbatohet nga kundërvajtësi (Kontrolluesi), brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e njoftimit. Për ekzekutimin e gjobës ngarkohet shërbimi përmbarimor gjyqësor;
11. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga data e njoftimit.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 28.04.2026.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 410/10 prot.

Tiranë, më 01.06.2026

**VENDIM**

**Nr. 13/1, datë 01.06.2026**

**PËR**  
**RISHIKIMIN E AKTIT ADMINISTRATIV**

Në mbështetje të neneve 144-146, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 27, datë 6.02.2026 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), u zhvillua hetimi administrativ pranë Kontrolluesit Shoqëria “Loft Construction” shpk (në vijim, “Kontrolluesi”), me objekt: “Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe garantimin e sigurisë së të dhënave personale gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga Kontrolluesi”.

Pas shqyrtimit të relacionit të grupit të hetimit, procesverbalit të konstatimit, si dhe provave të administruara gjatë procedurës së hetimit administrativ pranë Kontrolluesit, Komisioneri, me Vendimin nr. 13, datë 28.04.2026 (në vijim, “Vendimi nr. 13”), vendosi dënimin me gjobë të Kontrolluesit për shkelje të detyrimeve të parashikuara nga nenet 6, 7, 8, 27, 28, 30 dhe 33 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim, “Ligji”), si dhe ngarkimin e tij me detyrime shtesë, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së veprimtarisë përpunuese me kërkesat e përcaktuara nga Ligji.

Me shkresën nr. 410/9 prot, datë 15.5.2026 Kontrolluesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me kërkesë për rishikimin e aktit administrativ, Vendimi nr. 13, duke

pretenduar se disponon gjithë dokumentacionin e kërkuar nga inspektorët gjatë kryerjes së hetimit administrativ që ka sjellë në nxjerrjen e aktit administrativ për dënimin me gjobë të Kontrolluesit. Kjo, por për shkaqe të mosrakordimit të brendshëm, Kontrolluesi nuk ka mundur të vendosë në dispozicion informacionin e kërkuar nga grupi i hetimit administrativ.

Fillimisht. Zyra e Komisionerit vlerëson nëse kemi të bëjmë me një kërkesë për rishikim ndaj aktit administrativ, të parashikuar nga nenet 144 – 146 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, rishikimi është një mjet administrativ i jashtëzakonshëm që lejon rihapjen e një procedure administrative të përfunduar, kur pas nxjerrjes së aktit administrativ evidentohen fakte, rrethana ose prova me shkresë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes, të cilat kanë ekzistuar në kohën e marrjes së vendimit, por që nuk kanë qenë të njohura dhe nuk mund të merreshin në konsideratë nga organi publik gjatë procedurës administrative. Pala (Kontrolluesi) ka të drejtë të kërkojë anulimin ose ndryshimin e aktit administrativ nëse plotësohen parakushtet e rishikimit dhe nëse rrethanat apo provat me shkresë që janë bërë të njohura apo janë zbuluar, faktikisht, duhet të çojnë në anulimin apo ndryshimin e aktit administrativ.

Një parakusht tjetër për rishikimin është që ankimi administrativ (*pra mjete ligjor administrativ*) nuk mund të paraqitet për shkak të tejkalimit të afatit për paraqitjen e tij. Parashikimi i këtij mjete ligjor, vlerësohet si një rast përjashtimor, por që kërkon respektimin me rigorozitet të rregullave për zbatimin e tij.

Në nenin 144 të K.Pr.Administrative parashikohet se: “**1. Rishikimi është mjete ligjor administrativ, me anë të të cilit kërkohet anulimi apo ndryshimi i një akti administrativ të nxjerrë apo nxjerrja e një akti administrativ të refuzuar, kundër të cilit ankimi nuk është më i pranueshëm për shkak të kalimit të afatit të parashikuar nga ky Kod. 2. Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen dhe mund të dihen prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ.**”. Në vijim të këtij përcaktimi ligjor, Zyra e Komisionerit vlerëson se, parakushtet për anulimin apo ndryshimin nëpërmjet rishikimit të një akti administrativ, që nuk mund të ankimohet me mjetein e zakonshëm ligjor administrativ, janë si vijon:

- i. ***Paraqitja e rrethanave apo provave të reja me shkresë:*** prova të reja me shkresë janë vetëm dokumentet në formë të shkruar, të cilat janë të përshtatshme për të provuar pretendimet e palëve lidhur me fakte të rëndësishme të deklaruara nga pala në procedurën hetimore. Vetëm provat me shkresë mund të çojnë në rishikim. Ato duhet të zbulohen ose të gjenden rishtas, pas përfundimit të procedurës për nxjerrjen e aktit

administrativ. Po ashtu, edhe rrethanat duhet që të zbulohen ose të mësohen rishtas nga pala kërkuese.

- ii. ***Nuk diheshin dhe nuk mund të diheshin nga pala kërkuese:*** është e domosdoshme që të provohet që pala nuk i njihete dhe nuk mund t'i njihete si provat ashtu edhe rrethanat gjatë kohës që është kryer procedura administrative. Nëse pala ka pasur dijeni për faktin ose dokumentin, atëherë parakushtet e rishikimit nuk plotësohen.
- iii. ***Dokumentet apo faktet që do të çonin në një vendim tjetër:*** pala që kërkon rishikimin duhet të shpjegojë që organi publik do të kishte marrë një vendim të ndryshëm ose do të ishte nxjerrë një tjetër akt administrativ nëse dokumenti apo fakti do të ishin paraqitur gjatë procedurës administrative.

Në rastin konkret, lidhur me parakushtet procedurale të kërkesës për rishikim, Zyra e Komisionerit vlerëson se kërkuesi legjitimohet për të paraqitur kërkesë për rishikim në kuptim të nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative, për sa kohë që plotësohet kriteri i paankueshmërisë administrative të aktit.

Konkretisht, referuar pikës 11 të dispozitivit të Vendimit nr. 13, parashikohet se: *“Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e njoftimit.”* Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se ligji nuk parashikon ushtrimin e ankimit administrativ si mjet i zakonshëm juridik ndaj këtij akti, por vetëm të drejtën e kundërshtimit në rrugë gjyqësore. Për rrjedhojë, Zyra e Komisionerit vlerëson se akti administrativ në fjalë konsiderohet i pakundërshtueshëm administrativisht, dhe si i tillë, përmbushet kriteri procedural i parashikuar nga neni 144 i KPA-së, lidhur me pamundësinë e ushtrimit të ankimit administrativ ndaj aktit objekt rishikimi.

Në raport me parakushtet materiale të rishikimit, Zyra e Komisionerit vlerëson se dokumentacioni i depozituar nga kërkuesi duhet të analizohet në funksion të kriterëve të përcaktuara në nenin 144 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në raport me natyrën dhe qëllimin e institutit të rishikimit si mjet juridik administrativ me karakter përjashtimor. Në këtë kuptim, rezulton se dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi përbëhet nga politika, procedura, plane organizative, raporte auditimi dhe dokumente të tjera me shkresë, të cilat lidhen materialisht me një pjesë të konsiderueshme të gjetjeve të evidentuara në Vendimin nr. 13, veçanërisht në drejtim të masave teknike dhe organizative për sigurinë e informacionit, menaxhimin e riskut, kontrollin e aksesit, backup/restore, auditimin e brendshëm dhe administrimin e proceseve përpunuese. Në këtë aspekt, dokumentacioni i paraqitur përmbush kriterin formal të *“provave me shkresë”*, në kuptim të pikës “i” të analizës së mësipërme.

Megjithatë, lidhur me kriterin e dytë, që këto prova *“nuk diheshin dhe nuk mund të diheshin”* gjatë zhvillimit të procedurës administrative, Zyra e Komisionerit vlerëson se në rastin

konkret dokumentacioni i depozituar nga kërkuesi rezulton të mbajë data të mëparshme se periudha e zhvillimit të hetimit administrativ dhe, për rrjedhojë, provohet se këto dokumente kanë ekzistuar në momentin e kryerjes së kontrollit administrativ. Nga sa pretendohet nga kërkuesi, mosdepozitimi i tyre gjatë procedurës administrative nuk ka ardhur si pasojë e mungesës së ekzistencës së dokumentacionit apo pamundësisë objektive për ta siguruar atë, por për shkak të një mosrakordimi të brendshëm organizativ lidhur me administrimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar nga grupi i hetimit. Në këtë kuptim, Zyra e Komisionerit vlerëson se dokumentacioni i paraqitur përmbush kriterin e ekzistencës së provave me shkresë, të cilat kanë qenë të lidhura me periudhën objekt hetimi dhe me veprimtarinë përpunuese të Kontrolluesit gjatë zhvillimit të procedurës administrative.

Gjithashtu, në raport me kriterin e tretë, Zyra e Komisionerit vlerëson se dokumentacioni i depozituar nga kërkuesi paraqet relevance materiale për vlerësimin e një pjese të konsiderueshme të gjetjeve të evidentuara në Vendimin nr. 13, për sa kohë që ai lidhet drejtpërdrejt me ekzistencën e politikave, procedurave dhe masave teknike e organizative të kërkua nga Ligji.

Konkretisht, dokumentacioni i paraqitur lidhet me administrimin e sigurisë së informacionit, menaxhimin e riskut, kontrollin e aksesit, backup/restore, auditimin e brendshëm, vazhdimësinë e biznesit, menaxhimin e incidenteve dhe dokumentimin e proceseve përpunuese, të cilat përbëjnë një pjesë thelbësore të konstatimeve të pasqyruara në aktin administrativ objekt rishikimi. Në këtë kuptim, Zyra e Komisionerit vlerëson se, nëse ky dokumentacion do të ishte administruar dhe vlerësuar gjatë zhvillimit të procedurës administrative, ai do të kishte potencialisht ndikim në vlerësimin e disa prej gjetjeve të evidentuara gjatë hetimit administrativ, për rrjedhojë, edhe në përmbajtjen e vendimmarrjes administrative të nxjerrë ndaj Kontrolluesit.

Nga analiza e kërkesës për rishikim, dokumentacionit të depozituar nga kërkuesi, si dhe gjetjeve të evidentuara në Vendimin nr. 13, Zyra e Komisionerit vlerëson se shqyrtimi i themelit të kërkesës duhet të bëhet në raport me secilën prej shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, duke analizuar nëse provat me shkresë të administruara në fazën e rishikimit cenojnë bazën faktike dhe juridike mbi të cilën është mbështetur akti administrativ objekt rishikimi.

Lidhur me konstatimet e evidentuara mbi mungesën e politikave dhe procedurave të formalizuara për garantimin e sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, Zyra e Komisionerit vlerëson se pas administrimit të dokumentacionit të depozituar në kuadër të kërkesës për rishikim, këto gjetje nuk rezultojnë më të qëndrueshme në të njëjtën masë. Konkretisht, kërkuesi ka depozituar Politika të Sigurisë së Informacionit, Politikën e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ISMS), dokumentacion mbi rolet dhe përgjegjësitë në kuadër të ISMS, si dhe procedura të ndryshme organizative dhe

teknike, të cilat rezultojnë të kenë ekzistuar edhe gjatë periudhës së zhvillimit të hetimit administrativ. Në këtë kuptim, administrimi i këtij dokumentacioni cenon pjesërisht bazën faktike të konstatimit sipas të cilit Kontrolluesi nuk kishte formalizuar masa organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së përpunimit të të dhënave personale.

Po kështu, lidhur me konstatimet mbi mungesën e planeve dhe procedurave për menaxhimin e riskut, rezulton se kërkuesi ka depozituar Procedurën e Menaxhimit të Riskut, analiza të riskut, dokumentacion mbi monitorimin dhe vlerësimin e masave të sigurisë, si dhe procedura për menaxhimin e incidenteve të sigurisë së informacionit. Në këtë aspekt, Zyra e Komisionerit vlerëson se dokumentacioni i administruar cenon pjesërisht konstatimin sipas të cilit Kontrolluesi nuk kishte ndërmarrë masa të dokumentuara për identifikimin, analizimin dhe administrimin e rreziqeve që lidhen me përpunimin e të dhënave personale, në kuptim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit.

Gjithashtu, lidhur me konstatimet mbi mungesën e planeve të vazhdimësisë së biznesit (BCP), procedurave backup/restore dhe mekanizmave të rikuperimit të sistemeve, rezulton se kërkuesi ka depozituar Planin e Vazhdimësisë së Biznesit, procedura backup dhe restore, si dhe dokumentacion teknik mbi administrimin dhe rikuperimin e sistemeve. Për rrjedhojë, nuk mund të qëndrojë në të njëjtën masë konstatimi mbi mungesën absolute të masave të formalizuara për garantimin e disponueshmërisë dhe vijueshmërisë së sistemeve dhe shërbimeve të përpunimit të të dhënave personale.

Lidhur me konstatimet mbi mungesën e auditimeve të brendshme dhe monitorimit të vazhdueshëm të masave të sigurisë, rezulton se kërkuesi ka depozituar raporte auditimi dhe dokumentacion mbi auditimin e brendshëm të sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe sigurisë së informacionit. Në këtë kuptim, administrimi i këtij dokumentacioni cenon pjesërisht konstatimin sipas të cilit Kontrolluesi nuk kishte procese të dokumentuara auditimi dhe kontrolli të brendshëm në funksion të garantimit të sigurisë së përpunimit.

Lidhur me konstatimet mbi mungesën e procedurave për administrimin e log-eve, kontrollin e aksesit dhe gjurmueshmërinë e veprimeve në sistemet e informacionit, rezulton se kërkuesi ka depozituar politika të kontrollit të aksesit, procedura për të drejtat e aksesit të përdoruesve, procedura për monitorimin e rrjeteve, dokumentacion mbi administrimin e log-eve, si dhe procedura për përdorimin e kartave të aksesit dhe aksesin në ambientet teknike. Për rrjedhojë, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk mund të qëndrojë në të njëjtën masë konstatimi mbi mungesën absolute të mekanizmave të dokumentuar për kontrollin dhe gjurmueshmërinë e aksesit në sistemet që administrojnë të dhëna personale.

Gjithashtu, lidhur me konstatimet mbi mungesën e procedurave për menaxhimin e incidenteve të sigurisë së informacionit, rezulton se kërkuesi ka depozituar politika dhe procedura të posaçme për menaxhimin, raportimin dhe trajtimin e incidenteve të sigurisë së

informacionit. Në këtë kuptim, administrimi i këtij dokumentacioni cenon pjesërisht bazën faktike të konstatimit sipas të cilit Kontrolluesi nuk kishte mekanizma të formalizuara për reagimin ndaj incidenteve dhe administrimin e tyre.

Lidhur me konstatimet mbi mungesën e procedurave dhe politikave për administrimin e infrastrukturës IT dhe software-ve, rezulton se kërkuesi ka depozituar procedura për menaxhimin e software-ve, mirëmbajtjen e aplikacioneve, implementimin e projekteve, menaxhimin e ndryshimeve në rrjetin IT, zgjerimet e rrjetit lokal dhe monitorimin e rrjeteve. Për rrjedhojë, administrimi i këtij dokumentacioni cenon pjesërisht bazën faktike të konstatimeve mbi mungesën e dokumentimit të proceseve teknike që lidhen me administrimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

Po kështu, në lidhje me konstatimet mbi mungesën e masave teknike për mbrojtjen e sistemeve të informacionit, rezulton se kërkuesi ka depozituar politika mbi antivirusin dhe antispamin, politika për përdorimin e internetit, e-mailit dhe pajisjeve kompjuterike, politika për pajisjet portative, politika për menaxhimin e kapaciteteve të sistemit, si dhe politika për fjalëkalimet e përdoruesve. Në këtë kuptim, nuk mund të qëndrojë në të njëjtën masë konstatimi mbi mungesën absolute të masave teknike të formalizuara për administrimin dhe mbrojtjen e sistemeve të informacionit.

Lidhur me konstatimet mbi detyrimet e konfidencialitetit sipas nenit 30 të Ligjit, rezulton se kërkuesi ka depozituar marrëveshje tip konfidencialiteti, Kodin e Sjelljes dhe Kodin e Etikës së Biznesit, të cilat rezultojnë të kenë ekzistuar edhe gjatë periudhës së hetimit administrativ. Për rrjedhojë, administrimi i këtij dokumentacioni cenon pjesërisht konstatimin mbi mungesën e instrumenteve të brendshme që rregullojnë ruajtjen e konfidencialitetit dhe detyrimet e personelit që ka akses në të dhënat personale, ndonëse mbetet për t'u vlerësuar nëse përmbajtja konkrete e tyre përmbush standardet materiale të kërkuara nga neni 30 i Ligjit.

Në të njëjtën kohë, lidhur me konstatimet mbi mungesën e mekanizmave organizativë për trajnimin dhe ndërgjegjësimin e stafit në fushën e sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, rezulton se kërkuesi ka depozituar politika dhe procedura për menaxhimin e trajnimeve dhe eventeve. Në këtë aspekt, administrimi i këtij dokumentacioni cenon pjesërisht konstatimin mbi mungesën e masave organizative për administrimin e proceseve të trajnimit dhe ndërgjegjësimit të personelit.

Së fundi, lidhur me konstatimet mbi mungesën e proceseve të dokumentuara të përputhshmërisë dhe kontrollit të brendshëm, rezulton se kërkuesi ka depozituar procedura mbi kërkesat ligjore dhe kontraktuale, dokumentacion mbi mos-përputhjet, si dhe procedura mbi veprimet korrigjuese dhe parandaluese. Për rrjedhojë, administrimi i këtij dokumentacioni cenon pjesërisht bazën faktike të konstatimeve mbi mungesën e

mekanizmave të formalizuara të kontrollit të brendshëm dhe përputhshmërisë me kërkesat ligjore që burojnë nga Ligji.

Pavarësisht sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se një pjesë e shkeljeve të evidentuara në Vendimin nr. 13 vijnë të qëndrojnë, për sa kohë që ato nuk lidhen vetëm me mungesën formale të dokumentacionit apo procedurave të shkruara, por me mënyrën konkrete të implementimit dhe funksionimit praktik të proceseve përpunuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga Kontrolluesi.

Konkretisht, lidhur me shkeljet e neneve 6, 7 dhe 8 të Ligjit, që lidhen me publikimin e fotografive dhe videove të subjekteve të të dhënave personale në platformat “Facebook” dhe “Instagram”, rezulton se kërkuuesi nuk ka depozituar prova të reja me shkresë që provojnë marrjen paraprake të pëlqimit të lirë, të informuar dhe të shprehur qartë nga subjektet e të dhënave, sipas kërkesave të nenit 8 të Ligjit. Për rrjedhojë, administrimi i dokumentacionit organizativ dhe teknik në kuadër të kërkesës për rishikim nuk cenon bazën faktike dhe juridike mbi të cilën është mbështetur konstatimi i kësaj shkeljeje, për sa kohë që mungesa e pëlqimit përbën element thelbësor të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale në rrjetet sociale.

Po kështu, lidhur me konstatimet mbi mënyrën e administrimit të sistemit të video-survejimit (CCTV), vijnë të qëndrojnë gjetjet e evidentuara gjatë verifikimeve në vend (“on-site”), sipas të cilave disa kamera monitoronin ambiente të jashtme, rrugë kalimi, qytetarë dhe poste pune, në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe kufizimit të qëllimit të përpunimit. Në këtë aspekt, ekzistenca e politikave apo procedurave të shkruara nuk rrëzon konstatimin faktik të evidentuar gjatë kontrollit administrativ lidhur me orientimin konkret të kamerave dhe përpunimin e të dhënave personale të personave që nuk kishin lidhje me veprimtarinë e Kontrolluesit.

Gjithashtu, vijon të qëndrojë konstatimi lidhur me ruajtjen e të dhënave imazh/video përtej afatit ligjor prej 30 ditësh, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 6 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 03, datë 30.04.2025, “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video survejimit” (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”). Edhe pse kërkuuesi ka depozituar dokumentacion mbi procedurat dhe politikat e ruajtjes së të dhënave, nga gjetjet e hetimit administrativ rezulton se gjatë verifikimit konkret sistemi ruante të dhëna përtej afatit të lejuar ligjor. Për rrjedhojë, dokumentacioni i administruar nuk është i mjaftueshëm për të rrëzuar konstatimin mbi mënyrën faktike të funksionimit të sistemit CCTV në periudhën objekt kontrolli.

Po kështu, lidhur me konstatimet mbi infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, vijon të qëndrojë gjetja sipas së cilës organizimi i rrjetit të brendshëm të intranetit nuk ishte i qendëruar sipas modelit “domain controller” ose ekuivalent, duke sjellë mungesë të një arkitekture të unifikuar për administrimin e përdoruesve, autorizimeve dhe politikave të

sigurisë. Edhe pse kërkuesi ka depozituar dokumentacion mbi kontrollin e aksesit dhe administrimin e sistemeve, nga verifikimet konkrete në vend rezulton se infrastruktura teknike e implementuar nuk garanton standardet e kërkuara të sigurisë në raport me rrezikun e përpunimit të të dhënave personale.

Sa i takon detyrimin për caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale sipas nenit 33 të Ligjit, rezulton se Kontrolluesi ka depozituar prova me shkresë që provojnë se një nëpunës i tillë ishte emëruar gjatë periudhës së zhvillimit të hetimit administrativ. Megjithatë, vijon të qëndrojë konstatimi mbi mos njoftimin e caktimit të nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale sipas parashikimit të nenit 34 të Ligjit, në kushtet kur aktiviteti i Kontrolluesit përfshinte procese përpunimi që kërkonin monitorim të rregullt dhe sistematik të subjekteve të të dhënave në një shkallë të gjerë.

Në vlerësim të sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se provat me shkresë të administruara në kuadër të kërkesës për rishikim cenojnë pjesërisht bazën faktike mbi të cilën është mbështetur Vendimi nr. 13, veçanërisht në drejtim të konstatimeve që lidhen me mungesën e politikave, procedurave dhe dokumentimit të masave organizative e teknike për garantimin e sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Nga dokumentacioni i depozituar rezulton se Kontrolluesi dispononte, edhe gjatë periudhës së zhvillimit të hetimit administrativ, një sërë politikash, procedurash, planesh organizative, dokumentacioni teknik dhe mekanizmash të formalizuar që lidhen me menaxhimin e riskut, kontrollin e aksesit, backup/restore, auditimin e brendshëm, menaxhimin e incidenteve të sigurisë së informacionit, vazhdimësinë e biznesit, administrimin e infrastrukturës IT dhe ruajtjen e konfidencialitetit. Për rrjedhojë, rezulton se një pjesë e konstatimeve të evidentuara në vendim mbi mungesën absolute të masave organizative dhe dokumentimit të proceseve përpunuese nuk qëndrojnë në të njëjtën masë pas administrimit të këtyre provave me shkresë.

Megjithatë, Zyra e Komisionerit vlerëson se dokumentacioni i administruar në fazën e rishikimit nuk është i mjaftueshëm për të rrëzuar të gjitha konstatimet e evidentuara gjatë hetimit administrativ, për sa kohë që një pjesë e konsiderueshme e shkeljeve janë bazuar në verifikime konkrete të kryera gjatë kontrollit në vend, dhe lidhen me mënyrën faktike të implementimit të proceseve përpunuese dhe masave të sigurisë.

Konkretisht, vijnë të qëndrojnë konstatimet lidhur me publikimin e të dhënave personale në rrjetet sociale pa pëlqimin paraprak të subjekteve të të dhënave, orientimin e kamerave CCTV në ambiente publike dhe poste pune, ruajtjen e të dhënave imazh/video përtej afatit ligjor, dobësitë konkrete të infrastrukturës teknologjike të informacionit, si dhe mos njoftimi e caktimit të nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë aspekt, provat me shkresë të depozituara nuk provojnë në mënyrë të mjaftueshme implementimin efektiv dhe funksional të masave të kërkuara nga Ligji gjatë periudhës objekt hetimi.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit vlerëson se administrimi i dokumentacionit të paraqitur në kuadër të kërkesës për rishikim justifikon ndryshimin pjesërisht të aktit administrativ objekt rishikimi, vetëm në raport me ato konstatime dhe shkelje të cilat janë mbështetur kryesisht në mungesën e dokumentimit formal të masave organizative dhe teknike, ndërsa pjesa tjetër e gjetjeve, të bazuara në verifikime konkrete faktike dhe në mosrespektimin material të kërkesave të Ligjit, vijon të qëndrojë.

Për sa më lart, Zyra e Komisionerit vlerëson se ndryshimi i aktit administrativ duhet të reflektojë rivlerësimin e konstatimeve lidhur me nenet 27, 28, 30 dhe 34 të Ligjit, në masën që ato lidhen me mungesën e dokumentacionit dhe procedurave të formalizuara, pa cenuar pjesën e vendimit që lidhet me shkeljet materiale të neneve 6, 7, 8 dhe 34 të Ligjit, si dhe konstatimet faktike të evidentuara gjatë kontrollit administrativ.

Në të njëjtën kohë, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në funksion të respektimit të parimit të proporcionalitetit në ushtrimin e kompetencës administrative ndëshkimore, rivlerësimi i gjendjes faktike dhe juridike të çështjes ndikon drejtpërdrejt edhe në vlerësimin e proporcionalitetit të masës administrative me gjobë të vendosur ndaj Kontrolluesit. Konkretisht, për sa kohë që një pjesë e konsiderueshme e konstatimeve mbi mungesën e masave organizative dhe teknike rezultojnë të cenuara pas administrimit të provave me shkresë, masa administrative ndëshkimore nuk rezulton më në raport të drejtë dhe të balancuar me natyrën dhe shkallën e shkeljeve që vijnë të qëndrojnë.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson se qëllimi i garantimit të përputhshmërisë me kërkesat e ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” mund të arrihet në mënyrë efektive nëpërmjet lënies në fuqi të masave korrigjuese dhe detyrimeve administrative të vendosura ndaj Kontrolluesit, pa qenë e nevojshme ruajtja e sanksionit administrativ me gjobë.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të neneve 144, 145 dhe 146 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neneve 6, 7, 8, 27, 28, 30, 33, 34, 81-84, të Ligjit, si dhe mbi bazën e dokumentacionit të administruar gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim,

### **V E N D O S A:**

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës për rishikim të paraqitur nga Kontrolluesi Shoqëria “Loft Construction” shpk, administruar me shkresën nr. 410/9 prot., datë 15.05.2026;

2. Ndryshimin pjesërisht të Vendimit nr. 13, duke anuluar pikat 1 dhe 2 të dispozitivit të tij, lidhur me dënimin administrativ me gjobë të Kontrolluesit;
3. Lënien në fuqi të pjesës tjetër të Vendimit nr. 13, lidhur me konstatimet dhe detyrimet administrative të përcaktuara në dispozitivin e tij.
4. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga data e njoftimit.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 01.06.2026.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**